

## AKT THEMELIMI

### SHOQËRIA TREGTARE "TIRANA NORD" SH.P.K

TIRANË / SHQIPËRI  
DATË 04.08.2022

Sot, në Tiranë, më datë 04.08.2022 unë **Z. Ardian SINANI** i biri i Rifat dhe Lutfije lindur në Tiranë dhe me banim në Tiranë Bashkia Tiranë Njësia Administrative Nr. 4 Rruga "Selaudin ZORBA", i datëlindjes 18.06.19981, i identifikuar nëpërmjet dokumentit të identifikimit dhe Nr. Personal: I10618151F, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar dhe me gjendje civile beqar dhe unë **Z. Edison SINANAJ**, i biri i Qemal dhe Vitori, lindur në Tiranë dhe me banim në Tiranë Bashkia Tiranë Njësia Administrative Nr. 9 Rruga "Mine PEZA", Pallati Nr. 38, Nd Nr. 1 – 38, i datëlindjes 10.05.1978, i identifikuar nëpërmjet dokumentit të identifikimit dhe Nr. Personal: H80510184N, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar dhe me gjendje civile i martuar hartojmë dhe nënshkruaj në gjuhën Shqipe aktin e themelimit të shoqërisë "**TIRANA NORD**" SH.P.K. si më poshtë vijon bazuar në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" i ndryshuar, Ligjit Nr. 131/2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

### NENI 1 FORMA E SHOQËRISË

Formohet një shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (SH.P.K), që ushtron aktivitetin e saj sipas objektit në përputhje me Legjislacionin Shqiptar në fuqi, dhe në vecanti por jo ekskluzivisht vetem me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" të ndryshuar, me ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" të ndryshuar, Ligjin Nr.131/2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", si dhe me përcaktimet e aktit të themelimit si dhe statuti.

### NENI 2 EMRI I SHOQËRISË

Emri i shoqërisë është "**TIRANA NORD**" SH.P.K. Shoqëria mund të përdor edhe emërtimin e saj tregtar "**TIRANA NORD**" SH.P.K. Shoqëria do të përdorë edhe vulën e saj në të gjitha korrespondencat dhe/ose në të gjitha dokumentet e saj, e cila do të përbëhet minimalisht nga emri i shoqërisë dhe nga NIPT dhe nga çdo karakteristikë tjetër e nevojshme për shoqërinë. Themeluesi e ka zgjedhur emrin e shoqërisë dhe ky emër nuk është i regjistruar apo i bllokuar apo regjistruar më parë etj.

### NENI 3 ORTAKËT E SHOQËRISË

Shoqëria "**TIRANA NORD**" SH.P.K. krijohet dhe themelohet si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me dy ortak si më poshtë vijon:

- a) **Z. Ardian SINANI** i biri i Rifat dhe Lutfije lindur në Tiranë dhe me banim në Tiranë Bashkia Tiranë Njësia Administrative Nr. 4 Rruga "Selaudin ZORBA", i datëlindjes 18.06.1981, i identifikuar nëpërmjet dokumentit të identifikimit dhe Nr. Personal: I10618151F, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar dhe me gjendje civile beqar.
- b) **Z. Edison SINANAJ**, i biri i Qemal dhe Vitori, lindur në Tiranë dhe me banim në Tiranë Bashkia Tiranë Njësia Administrative Nr. 9 Rruga "Mine PEZA", Pallati Nr. 38, Nd Nr.





1 – 38, i datëlindjes 10.05.1978, i identifikuar nëpërmjet dokumentit të identifikimit dhe Nr. Personal: H80510184N, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar dhe me gjendje civile i martuar.

#### **NENI 4 SELIA E SHOQËRISË**

Selia e shoqërisë “**TIRANA NORD**” SH.P.K. ndodhet me adresë: “**Tiranë Bashkia Kamëz Rruga “Bulevardi BLU”, Lagjia Bathore Nr. 7, Bashkia Kamëz**”. Trasferimi i selisë së shoqërisë në një tjetër adresë bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve dhe sipas procedurave ligjore dhe/ose nënligjore në fuqi për këtë qëllim duke bërë regjistrimin pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, si dhe duke bërë njoftimet e tjera sipas legjislacionit në fuqi (administratën tatimore qendrore dhe vendore). Shoqëria mund të vendos të hapi brenda dhe jashtë vendit, degë dhe/ose zyra përfaqësimit sipas procedurave ligjore dhe/ose nënligjore në fuqi duke bërë regjistrimet e nevojshme sipas legjislacionit shqiptarë dhe/ose të huaj në fuqi për këtë qëllim.

#### **NENI 5 OBJEKTI / VEPRIMTARIA TREGTARE E SHOQËRISË**

Shoqëria “**TIRANA NORD**” SH.P.K. ka si objekt të veprimtarisë tregtare së saj, por pa u kufizuar, si vijon: “**Ndërtim dhe/ose Projektim, Konsulencë Ndërtimi, Projektim objektesh të permasave të ndryshme, objekte banimi dhe shërbimit civile, shtëpi, vila, ndërtesa shumëkateshe dhe komplekse pallatesh, objekte banimi dhe shërbimi polifunksionale, ndërtim objektesh civile turistike dhe industriale, ndërtim rrugesh, urash, ndertime portuale detare dhe ajrore, galeri, tunele, asfaltim dhe veshje me asfalt, ndërtim vepra kullimi, ujitje, impiante ndërtime betoni dhe prodhime inertesh, ndërtime rrugë, rikonstruksion i objekteve të ndryshme, mirëmbajtje, punime fasade, murature rifinitura, gipsi, boje, shtrim dysHEMEJE, punime elektrike dhe hidraulike. Ndërtim parqe lulishte Ndërtime betoni, Projektimi i godinava parqe lulishte vepra inxhinjerike. Blerje dhe/ose shitje pronash. Administrim të pronave, shitjeve dhe/ose blerjese të pronave si dhe qiradhënje të tyre, etj. Shoqëria “**TIRANA NORD**” SH.P.K. mund të ushtrojë çdo aktivitet tjetër tregtar civil, privat ose edhe për llogari të subjekteve publik apo në partneritet me subjektet publike. Shoqëria “**TIRANA NORD**” SH.P.K. mund të ushtrojë cdo aktivitet tragtarë që skëron licencim fillestar kurse për ato që kërkohet licencim do ti ushtrojë pas marrjes së lejes / të drejtës / licencës përkatëse”. Për realizimin e objektit të veprimtarisë së saj shoqëria mund gjithashtu të blejë dhe të shesë pasuri të luajtshme dhe/ose të paluajtshme, të kryeje çdo lloj operacioni financiar aktiv e pasiv, të ndërmarrë e të zhvillojë çdo lloj aktiviteti industrial, tregtar, që konsiderohen të dobishme dhe të përshtatshme, si dhe fitimprurëse për shoqërisë në përputhje me legjislacionin shqiptarë në fuqi dhe/ose me legjislacionin e huaj për këtë qëllim. Shoqëria dhe sipas interesit të ortakut të saj mund të ushtroje aktivitet tregtar fitimprurës të tjera nga ajo e përcaktuar në këtë neni, duke respektuar paraprakisht çdo kërkesë ligjore dhe/ose nënligjore në fuqi për këtë qëllim. Për aktivitet e përmendura më sipër shoqëria (si dhe ato të papërmendura dhe të lejuara në bazë të legjislacionit në fuqi) mund t'i kryeje në sektorin publik, të administratës publike në përgjithësi, si dhe në sektorin privat. Aktivitete të tilla mund të kryhen nga shoqëria si drejtpërdrejtë dhe nëpërmjet subjekteve të treta me qëllimet e dhëna ose pjesëmarrëse ose të kontrolluar. Shoqëria me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, në bazë të dispozitave të aktit të themelimit, statutit dhe në përputhje me ligjin/legjislacionin në fuqi, mund të marrw drejtpërdrejtë ose indirekt interesa ose pjesëmarrje, duke përfshirë edhe ato aksionare, në shoqëri dhe/ose në ndërmarrje të ndryshme në Shqipëri dhe/ose në vende të tjera jashtë Shqipërisë, që kanë objekt të ngjashm, të njëjtë ose kanë lidhje me objektin e saj ose me qëllim fitimprurëse për shoqërinë. **Shoqëria nuk ka për të kryer asnjë****



**aktivitete pa marrë paraprakisht licencat apo lejet e nevojshme sipas legjislacionit shqiptar në fuqi apo legjislacionit të shteteve të huaja ku mund të ushtrojë aktivitetin e saj.**

## **NENI 6 KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

Kohëzgjatja e aktivitetit/veprimtarisë të shoqërisë “**TIRANA NORD**” **SH.P.K.** është e pakufizuar. Kohëzgjatja e aktivitetit/veprimtarisë të shoqërisë fillon nga data e regjistrimit në regjistrin tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR) / Biznesit (QKB) dhe nëse kërkohet nga ligji pas marrjes së licencave përkatëse për ushtrimin e aktivitetit tregtar.

## **NENI 7 KAPITALI I SHOQËRISË**

Kapitali bazë fillestar i shoqërisë “**TIRANA NORD**” **SH.P.K.** është 10,000.00 (dhjetë mijë) lek dhe tërësisht i paguar nga dy ortakët e shoqërisë sipas pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë.

Kontributi i ortakëve përbën kapitalin themeltar dhe të regjistruar të shoqërisë “**TIRANA NORD**” **SH.P.K.** Kapitali shoqërisë “**TIRANA NORD**” **SH.P.K.** përbëhet nga 2 kuota si më poshtë vijon:

- a) **Kuota I** e cila përfaqëson **60 (gjashtëdhjet) %** të kapitalit të shoqërisë “**TIRANA NORD**” **SH.P.K.** me të gjitha të drejtat dhe detyrimet në pronësi / emër të **Z. Ardian SINANI** i identifikuar si më sipër.
- b) **Kuota II** e cila përfaqëson **40 (dyzet) %** të kapitalit të shoqërisë “**TIRANA NORD**” **SH.P.K.** me të gjitha të drejtat dhe detyrimet në pronësi / emër të **Z. Edison SINANAJ** i identifikuar si më sipër.

## **NENI 8 KONTRIBUTET NË KAPITALIN BAZË / FILLESTAR TË SHOQËRISË**

**Kapitali bazë përbëhet nga kontributi i ortakëve si më vijon:**

- a) **Z. Ardian SINANI** kontribon me 60 % në kapitalin e shoqërisë “**TIRANA NORD**” **Sh.p.k.** dhe ka / zotëron me të drejta dhe detyrime të plota Kutën I e cila përfaqëson 60 % të kapitalit të shoqërisë “**TIRANA NORD**” **Sh.p.k.**
- b) **Z. Edison NINANAJ** kontribon me 40 % në kapitalin e shoqërisë “**TIRANA NORD**” **Sh.p.k.** dhe ka / zotëron me të drejta dhe detyrime të plota Kutën II e cila përfaqëson 40 % të kapitalit të shoqërisë “**TIRANA NORD**” **Sh.p.k.**

Shoqëria mund të lëshojë një certifikatë, e cila provon zotërimin e kuotave të kapitalit nga ortaku i saj sipas dispozitave ligjore në fuqi për këtë qëllim. Administratori, sipas nevojës mund të marrë vërtetim mbi statusin e kuotave të shoqërisë pranë Regjistrin të Barrëve të Sigurimit (RBS) dhe/ose çdo institucion tjetër kompetent për këtë qëllim sipas dhe në përputhje me ligjin në fuqi. Çertifikata e lëshuar në emër të personit ose personave që zotërojnë kuotat në këtë shoqëri nuk mund të konsiderohet titull/letër me vlerë dhe/ose të vendoset si garanci. Pjesa që formon kapitalin themeltar, nënshkruhet, shlyhet plotësisht, nga ortaku i vetëm i shoqërisë “**TIRANA NORD**” **SH.P.K.**

## **NENI 9 ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË**





Organet e shoqërisë “TIRANA NORD” SH.P.K. janë si më poshtë vijon: **Asambleja e Përgjithshme; Administratori/et ose organe të tjera që krijohen nga Asambleja.**

### NENI 10 ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Shoqëria “TIRANA NORD” SH.P.K. administrohet nga administratori: **Z. Ardian SINANI** i biri i Rifat dhe Lutfije lindur në Tiranë dhe me banim në Tiranë Bashkia Tiranë Njësia Administrative Nr. 4 Rruga “Selaudin ZORBA”, i datëlindjes 18.06.1981, i identifikuar nëpërmjet dokumentit të identifikimit dhe Nr. Personal: I10618151F, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar dhe me gjendje civile beqar.

Shoqëria “TIRANA NORD” SH.P.K. dhe pas krijimit të saj dhe fitimit të personalitetit juridik shpërblen administratorin e saj të zgjedhur me një pagë mujore bruto prej **40.000 (dyzete mije) lek**. Kontrata e Punës së Administratorit rregullohet sipas legjislacionit Shqiptar në fuqi për këtë qëllim.

Shoqëria mund të ketë më shumë se një administrator kur vendoset nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të shoqërisë “TIRANA NORD” SH.P.K. dhe regjistrohet si i tillë pranë QKB. Shpërblimi i administratorit duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorëve dhe gjendjen financiare të shoqërisë. Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, Ortaku i vetëm ose Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të administratorëve në masën e përshtatshme. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Afati i emërimit, i cili caktohet në statut, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje, me përjashtim të rasteve të dorëheqjes ose të pushimit të papritur. Administratori emerohet në këtë detyrë për një periudhë kohore 5 (pesë) vjeçare me të drejtë rizgjedhje. Kontrata e punës së administratorit dhe kur administratori është i ndryshëm nga ortaku i vetëm i shoqërisë duhet të miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve. Administratori ka të drejta dhe detyrime si më poshtë citohet në përputhje me ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe me këtë akt themelimi dhe/ose statut:

- a) kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqëson shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryen regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g) raportojn përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) kryen detyra të tjera që i caktohen nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.
- i) Informon Asamblenë e Përgjithshme mbi ndryshimet ligjore që kanë lidhje me aktivitetin tregtar të shoqërisë, si dhe me aktet bazë të shoqërisë tw tilla si por jo vetëm si statuti, rregullore tw tjera tw shoqërisë, etj.
- j) Të propozojë përmirësime dhe/ose përshtatje me legjislacionin shqiptar në fuqi të statutit të shoqërisë, tw rregulloreve tw shoqërisë etj.



Administratori, gjatë kryerjes së detyrave, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim. Administratori është përgjegjës kundër shoqërisë ose të tretëve, si për shkelje të ligjit, ashtu edhe për shkelje të statutit ose për faje të kryera gjatë administrimit të tij. Administratori mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve. Administratori, që jep dorëheqjen, duke pasur parasysh rrethanat e veprimtarisë së shoqërisë, është gjithashtu i detyruar të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve për emërimin e administratorit të ri, përpara datës në të cilën dorëheqja të hyjë në fuqi. Nëse Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve nuk vendos emërimin e administratorit të ri në datën e përcaktuar në thirrjen e kryer nga administratori i dorëhequr, atëherë administratori i njofton me shkrim dorëheqjen Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me kopjen e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve dhe Qendra Kombëtare e Regjistrimit regjistron largimin e administratorit, sipas procedurave të ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007, "Per Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar. Dorëheqja e administratorit nuk cenon paditë e shoqërisë për shkelje të detyrimit të besnikërisë që administratori ka ndaj saj, sipas këtij ligji. Emërimi i administratorit/rëve të ri/rinj, hyn në fuqi në datën e përcaktuar sipas aktit të emërimit, dhe u kundrejtohet palëve të treta sipas përcaktimeve të nenit 12 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar.

## **NENI 11 PËRFAQËSIMI I SHOQËRISË**

Kufizimet e tagrave të përfaqësimit të administratorit/ëve i kundrejtohen palëve të treta, në përputhje me dispozitat e nenit 12 të ligji Nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqërisë tregtare" i ndryshuar. Administratori/ët, që përfaqësojnë bashkërisht shoqërinë tregtare, mund të autorizojnë disa prej tyre për kryerjen e disa veprimeve të caktuara apo për kryerjen e disa kategorive të caktuara veprimesh. Përfaqësimi ligjor i shoqërisë (i drejtëpërdrejtë ose i deleguar me autorizim) është i vlefshëm për çdo veprim gjyqësor apo jashtëgjyqësor. Veprimet e kryera nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë (i drejteperdrejte ose i deleguar me autorizim) janë të detyrueshme për shoqërinë edhe nëse këto tejkalojnë objektin e saj, me përjashtim të rastit kur këto veprime shkojnë përtej tagrave të përfaqësimit që u jep ligji apo lejon t'u jepen përfaqësuesve. Këto veprime nuk janë detyruese për shoqërinë nëse shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni se akti tejkalon objektin e saj, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të. Publikimi nëpërmjet ndryshimit të statutit nuk përbën provë të mjaftueshme për dijeninë e të tretëve, nëse ky ndryshim është bërë publik në mënyrë të ndryshme nga ato të parashikuara nga ligji për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Njoftimet e drejtuara secilit prej administratorëve janë të vlefshme e detyruese për shoqërinë. Tagrat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Të gjitha shkresat, formularët e urdhrave apo çdo dokument tjetër korrespondencë, nxjerrë nga shoqëria, degët apo zyrat e përfaqësimit, nëpërmjet përdorimit të letrës ose mjeteve elektronike, të cilat u drejtohen palëve të treta, duhet të përmbajnë të dhënat e mëposhtme: numrin unik të identifikimit; formën ligjore të shoqërisë; vendndodhjen e selisë së regjistruar dhe të zyrës qendrore të saj; të dhëna nëse shoqëria është në likuidim; Nëse shoqëria ka faqe interneti, këto të dhëna duhet të pasqyrohen aty.


## **NENI 12 TË NDRYSHME**




Cdo gjë që tjetër dhe/ose më e detajuar parashikohet në statutin e shoqërisë, dhe/ose në legjislacionin shqiptar në fuqi për këtë qëllim, kopje e të cilit do të depozitohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (Q.K.R) / Biznesit (Q.K.B) me qëllim jo vetëm regjistrimi.

**THEMELUESIT E SHOQËRISË  
"TIRANA NORD" SH.P.K.**

**Z. Ardian SINANI**

  
\_\_\_\_\_  
**NËNSHKRIMI (ORTAKU DHE ADMINISTRATORI)**

**Z. Edison SINANAJ**

  
\_\_\_\_\_  
**NËNSHKRIMI (ORTAK)**

